

Data \_\_. \_\_. 2024

## **PROCESVERBAL**

### **PËR MOS-NDARJEN NË LOTE TË PROCEDURËS SË HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore në SUT” për një periudhë 48 mujore” - Marrëveshje Kuadër me një Operator Ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 48 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër

*Fondi limit:* **138,000,000** (njëqind e tridhjetë e tetë milionë) **Lekë pa TVSH** ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit i datës 11.10.2024 nga BSH): **1,396,761.13** (një milion e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pik trembëdhjetë) **Euro pa TVSH**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Mbledhja, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore - 90524400-0**

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Universitar i Traumës** ka hartuar procesverbalin për për mos-ndarjen në lote të procedurës së Hapur mbi kufirin e lartë monetar, me arsyetimin si më poshtë:

1. Procedura e prokurimit është shërbim specifik me objekt Mbledhjen, transportin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore për të cilat kerkohen licenca specifike, investime të konsiderueshme në teknologji, pajisje, makineri dhe nënreze për të cilat mund të ofertohen vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomike në tregun shqipëtar.

Nuk mund të ndahet në lote pasi ndarja në lote sipas kodeve të mbetjeve mund të çojë në dështimin e lotëve për të cilat sasia apo vlera e parashikuar është e ulët dhe nuk justifikon investimin apo kostot e nevojshme për të trejtuar ato kode mbetjesh.

2. Nga eksperiencia e Ak në kryerjen e këtij shërbimi rezulton se numri i OE është i kufizuar në tregun shqipëtar dhe për nga rëndësia që ka procesi i trajtimit të mbetjeve, OE duhet të kenë investuar në sigurimin e makinerive/pajisjeve që mundësojnë këtë shërbim.

3. Ndarja në lote do të krijonte konfuzion tek OE pjesëmarrës dhe kosto shtesë për AK në kryerjen e procedurave të prokurimit dhe në zbatimin e kontratave të trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore.

**Njësia e Prokurimit:**